

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi me 18 vjet burgim, avokati i Veselit: Ditë e keqe për drejtësinë ndërkombëtare, vendimin do ta dërgojmë në Apel - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/denimi-me-18-vjet-burgim-avokati-i-veselit-dite-e-keqe-per-drejtesin-e-nderkombetare-vendimin-do-ta-dergojme-ne-apel/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:11:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:08:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	98bb1b30fe88555f49deccb70401f1bf1098cbcf6d658e8f3a755eec581833fb0
TEKSTI	0f9be289d7a11f7b4331b292ee1904e1578d524c08d574dca4443c98e1470294
PAMJA	80785e22ae0b37f4c652cc9a6276e488d51742b23564ae70a0224a378b0e05aa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e88d561bb347ce3cb09175dff6f0715cc008ad3d1900afec09e41f30df56ed36
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e88d561bb347ce3cb09175dff6f0715cc008ad3d1900afec09e41f30df56ed36>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK SHBA Edi Rama Kadri Veseli Hysni Gucati

KOSOVË | RAJONI

Dënimi me 18 vjet burgim, avokati i Veselit: Ditë e keqe për drejtësinë ndërkombëtare, vendimin do ta dërgojmë në Apel

16 Shtator 2026 | 13:08

Avokati i Kadri Veselit, Rodney Dixon, e ka konsideruar zhgënjyes vendimin dënues të Dhomave të Specializuara ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai tha se vendimi i sotëm i Speciales nuk është ditë e mirë për sundimin e ligjit, të drejtën ndërkombëtare dhe as Kosovën.

Dixon theksoi se vendimin për burgim me 18 vjet burgim ndaj Kadri Veselit do ta dërgojnë në apel për të vazhduar luftën për pafajësinë e tij.

"Jemi thellësisht të zhgënjyer me aktgjykimin fajësues dhe dënimin e shpallur këtë mëngjes. Gjatë gjithë procesit gjyqësor, në emër të z. Veseli, kemi theksuar qartë mungesën e provave për përfshirjen e tij në ndonjë rrëmbim, vrasje apo aktivitet kriminal gjatë luftës për lirinë e Kosovës. Fatkeqësisht, kjo nuk është një ditë e mirë për Kosovën. Nuk është një ditë e mirë as për sundimin e ligjit dhe as për të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, ne do ta shqyrtojmë me shumë kujdes këtë aktgjykim të gjatë, të cilin sapo e kemi pranuar, me qëllim që të paraqesim një apelim të fuqishëm dhe të vazhdojmë luftën për të dëshmuar pafajësinë e z. Veseli dhe për ta kthyer atë në shtëpi, në Kosovë", tha ai.

Ai nuk pranoi të flasë në detaje për apelin, por shtoi se Veseli është në gjendje të mirë shpirtërore dhe i gatshëm të vazhdojë luftën kundër vendimit të Speciales.

"Nuk jam në gjendje t'u përgjigjem tani për pyetje të detajuara. Jam i sigurt se e kuptoni që procedurat janë duke vazhduar. Por dua ta bëj të qartë se ne do ta shqyrtojmë këtë aktgjykim dhe do të paraqesim një apelim shumë të fuqishëm kundër tij. Shkurtimisht, ai është në gjendje të mirë shpirtërore dhe është i gatshëm të vazhdojë luftën. Nuk mund të hyj në më shumë detaje rreth vendimit. Ne do ta shqyrtojmë atë dhe do të ndërmarrim hapat e ardhshëm për të luftuar për z. Veseli", tha ai.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

13:00 Gucati pas vendimit në Hagë: Gjykatë kriminale, dënon pa argumente. Shpresa nuk humb

12:53 Vengu kundër vendimit të Gjykatës Speciale: "Strehë e padrejtësisë", kërkon rrëzimin e dënimeve në apel

12:45 Rritja e çmimit të naftës, ministrja Ibrahimaj njofton ringritjen e Bordit të Transparencës

12:44 Begaj për dënimin e ish-krerëve të UÇK: Trishtim i thellë, liria ka emër

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

12:38 Vendimi i Gjykatës Speciale, mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së përplasen me policinë në Hagë (VIDEO)

12:33 Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Haxhiu: Lajm tronditës për Kosovën, aktgjykimet nuk e rishkruajnë dot historinë

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

Gucati pas vendimit në Hagë: Gjykatë kriminale, dënon pa argumente. Shpresa nuk humb

Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati pa vendimit të dhënë këtë të mërkurë nga Gjykata Speciale në Hagë ka reaguar për mediat. Ai theksoi se gjykata e...

13:00 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI | VENDI

Begaj për dënimin e ish-krerëve të UÇK: Trishtim i thellë, liria ka emër

Presidenti Bajram Begaj ka reaguar këtë të mërkurë lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë. Ai shprehet se vendim i...

12:44 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Vendimi i Gjykatës Speciale, mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së përplasen me policinë në Hagë (VIDEO)

Përleshje mes mbështetësve të UÇK-së dhe policisë kanë shpërthyer në Hagë, pas vendimit të marrë nga Gjykata Speciale ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit...

12:38 | 16/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.